



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:064766

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05643493

KF.nr.367/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin administrativ të paditësit “Doni Product” SHPK me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” SHPK me seli Prishtinë, Soliteri Avalla P+12, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti vlerësim doganor, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 26.04.2024 në mungesë të përfaqësueses së autorizuar të paditësit, dhe në prani të përfaqësueses të palës së paditur A.H.D., mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Doni Product” SHPK me seli në Ferizaj, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr. 01.3.2.2/2251 i datës 26.02.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 07.04.2021, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 01.3.2.2/2251 i datës 26.02.2021, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe rritjes së paarsyeshme të çmimit të mallit, duke propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e ushtruar ndaj aktvendimit të Doganës së Kosovës

nr. 01.3.2.2/2251 i datës 26.02.2021, të anulohet si i pabazuar aktvendimi kontestues nr. 01.3.2.2/2251 i datës 26.02.2021, dhe të obligohet e paditura të kthej mjetet monetare të paguara më tepër në emër të detyrimeve doganore t'iu kthehen ankuesit në xhirollogarinë bankare Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor përfaqësuesi i paditësit nuk ka prezantuar ndonjëse të njëjtit janë ftuar në mënyrë të rregullt, ku nga shkresat e lëndës konstatohet se ftesën e ka pranuar me datë 15.04.2024, mirëpo prezencën nuk e ka arsyetuar.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 22.03.2024 e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Shton se aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme, andaj i propozon gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor, përfaqësuesja e të paditurës ka theksuar se qëndrojnë prapa përgjigjes në padi në të cilën e kundërshtojmë padinë dhe kërkesë padinë e paditësit si të pabazuar në dispozita ligjore pasi që aktvendimi i atakuar në padi është marrë konform dispozitave ligjore dhe KDA. Tutje ka shtuar se paditësi në procedurën administrative të zhvilluar pranë të paditurës në procedurën e zhdoganimit si dhe në procedurën ankimor nuk ka paraqitur dokumentacion në të cilën e mbështet vlerën e transaksionit të importit që kanë qenë objekt kontesti pasi që i njëjti nuk ka paraqitur kontratën e shitblerjes lidhur me çmimin e kontraktuar, kushtet e pagesës si dhe transaksionet bankare të realizuara për mallrat kontestuese. Po ashtu paditësi nuk ka prezantuar as deklaratën eksportuese të shtetit eksportues e cila përpilohet në momentin e eksportit të mallit. E paditura thekson se paditësi për importet e cekura në pikën 3 të dispozitivit të aktvendimit të atakuar në padi i njëjti me paraqitjen e ankesës pranë të paditurës ka lëshuar afatin ligjor sipas nenit 291 par 2 i KDA-së. Andaj duke u bazuar në të cekurat më lartë dhe shkresat e lëndës i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke e lënë në fuqi vendimin kontestues si të drejtë dhe të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 11.04.2024 ka administruar provat si në vijim: Aktvendimi 01.3.2.2/2251 i datës 26.02.2021 ,DUD R52 i datës 04.01.2021 dhe urdhërpagesë, Faturë 0003/2021 dhe kalkulimi i vlerës nga paditësi ,DUD R 117 i datës 05.01.2021 dhe Urdhërpagesë, Faturë 0005/2021 dhe kalkulimi ,DUD R251 datë 07.01.2021 dhe Urdhërpagesë

,Faturë 000/2021 dhe kalkulimi ,DUD R296 i datës 08.01.2021 dhe Urdhërpagesë, Faturë 0034 dhe kalkulimi, DUD R-402 i datës 11.01.2021 dhe Urdhërpagesë, Faturë nr. 17 dhe 18 dhe kalkulimi DUD R- 403 i datës 11.0.2021 dhe urdhërpagesë, Faturë 0018/2021 dhe kalkulimi, DUD R-188 i datës 06.01.2021 dhe urdhërpagesë, Faturë e datës 02.01.2021 dhe kalkulimi, DUD R- 367 dhe urdhërpagesë, Faturë 0012/2021 dhe kalkulimi, DUD R -654 i datës 14.01.2021 dhe urdhërpagesë, Faturë 0025/2021 dhe kalkulimi, DUD R-757 i datës 14.01.2021 dhe urdhërpagesë, dhe faturë e datës 11.01.2021, Faturë 14.01.2021 dhe kalkulimi ,DUD R-652 i datës 13.01.2021, Dosja me të dhënat e disponueshme e datës 01.02.2021 dhe 11.01.2021.

Gjykata, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë duke argumentuar se sektori i pranimit qendror ka vepruar drejtë kur gjatë përcaktimit të vlerës së mallrave është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit konform nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme-dosja e vlerës.

Gjykata konstaton se pavarësisht pretendimeve të paditësit në padi, se të gjitha dokumentet e nevojshme për mallin lëndor janë paraqitur, sipas Nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr. 11/2009 për Implementimin e Kodi Doganor dhe Akcizave të Kosovës, gjen se dokumentacioni për mallin lëndor paraqitur në këtë çështje tregtare administrative është i pamjaftueshëm për të vërtetuar vlerën reale të mallit lëndor, siç pretendon paditësi.

Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmojë vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor Evrotas Fruit, Greqi. Pala paditëse edhe pse i ka prezantuar gjykatës provat materiale si Deklaratat doganore, faturat e mallit, megjithatë nuk ka arrit të dëshmojë pagesën e mallit lëndor si dëshmi se është deklaruar vlera reale e mallit doganor, prandaj gjykata konstaton se dokumentacioni përcjellës i mallit i paraqitur nga

paditësi është provë e pa mjaftueshme për ti vërtetuar pretendimet se është paguar vlera reale e mallit lëndor.

Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës posedon mallra të ngjashme të zhdoganuara në periudhë të afërt kohore me mallin lëndor kontestues e që kanë ndikuar që e njëjta si fakte vendimtare i ka marr për bazë gjatë rivleresimit e mallit lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Gjykata vlerëson se provat e tilla me të cilat është rivlerësuar malli lëndor sipas dosjes së vlerës-të dhënat për pemë dhe perime, është provë e bazuar për tu vlerësuar malli lëndor sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, prandaj gjykata konstaton se është aplikuar drejt dispozita ligjore kur është rivlerësuar malli lëndor sipas dosjes së vlerës.

Rrjedhimisht, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se nga pretendimet e fakteve të paraqitura në procedurën e konfliktit administrativ, nuk janë paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin vlerën e transaksionit të mallit lëndor.

Nga kjo gjendje faktike, gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Neni 43, par 1. i LKA-së, “Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”, andaj paditësi në këtë kontest tregtar administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të ankesës, ashtu siç parashihet me nenin Neni 81 F, paragrafi 1 dhe 81 E, paragrafi 4, pika 4 dh 5 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 .

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit,

andaj thënie të padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Nga të lartcekurat, Gjykata konform nenit 43 para., 1, dhe nenit 46, para. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.367/22, datë 26.04.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.